

SHPALLJE PËR REKRUTIM EKSPERTËSH TË JASHTËM

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të nenit 50, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm të kualifikuar në fushën e Filmit dhe Medias për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Dokumentar për 20-vjetorin e AMA-s”.

TERMAT E REFERENCËS

Objektivi

Si punë e parë e këtij lloji në 20 vite eksperiencë si institucion, AMA kërkon të prezantojë nëpërmjet dokumentarit, historinë e tij, por edhe analizën e terrenit të krijimit dhe zhvillimit të autoritetit, përgjatë këtyre 20 viteve në Shqipëri.

Kohëzgjatja e dokumentarit duhet të jetë 30 – 45 min.

Detyrat

Eksperti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Realizimi i skenarit;
- Përcaktimi i fondit limit;
- Ndjekja e procedurës së prokurimit;
- Ndjekja e realizimit të kontratës së shërbimit për prodhimin e dokumentarit.

Periudha e zbatimit të detyrave:

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë deri në realizimin/marrjen në dorëzim të dokumentarit.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm

1. Të zotërojë diplomën e bachelor në Film dhe Media. Kualifikimet në fushën e Regjisë, Skenarit ose Produksionit do të përbëjnë avantazh;
2. Të jetë i/e përgatitur të parashikojë format e ndryshme të produksionit në terren dhe në kohë;
3. Të ketë eksperiencë në marrëdhënie me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e filmit, televizionit, marketingut dhe organizimit të eventeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
4. Të ketë ushtruar aftësitë prodhuese në punë të ngjashme;
5. Të jetë shtetas/e shqiptar;

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Diploma e Bachelor në Film dhe Media;
2. Kualifikime të tjera në fushën e Regjizurës;
3. Dokumentacion që vërteton punë të ngjashme;
4. Dokumentacion që vërteton punë të ngjashme me institucione ndërkombëtare;
5. Jetëshkrimi;
6. Kopje ID/Pasaportë;

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

- | | |
|---|---------|
| 1. Diploma e shkollës së lartë; | 20 pikë |
| 2. Kualifikime të tjera në fushën e Regjizurës; | 10 pikë |
| 3. Dokumentacioni për punë të ngjashme; | 40 pikë |
| 4. Dokumentacioni për punë të ngjashme me institucione ndërkombëtare; | 20 pikë |
| 5. Jetëshkrimi; | 10 pikë |

Produktet dhe materialet

Eksperti do të paraqesë në gjuhën shqipe të gjitha propozimet, rekomandimet, dokumentet e hartuara, në AMA.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë

APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 28 SHKURT 2019